



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-087 për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, e konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

**Për miratimin e raportit për vitin 2024, të komisionit komunal të aksionarëve të
NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A.**

Neni 1

MIRATOHET- Raporti për vitin 2024 i performancës së Komisionit komunal të aksionarëve për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi në Ndërmarrjes Publike Lokale **“Stacioni i autobusëve” SH.A.** me seli në Suharekë.

Neni 2

Raporti i cekur në neni 1, të këtij vendimi është shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat e nenit 8, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe raporti me numër të protokollit 01-Nr-016-37878 i datës 03.07.2025, i përgatitur nga anëtarët e Komisionit Komunal i Aksionarëve.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N S Ë N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____

Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI